L I G J
Nr.9569, datë 3.7.2006

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË BELGJIKËS PËR TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Belgjikës për transportin ndërkombëtar rrugor".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4985, datë 21.7.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË BELGJIKËS PËR TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR

Qeveritë e Republikës së Shqipërisë dhe të Mbretërisë së Belgjikës, të quajtura më poshtë Palë Kontraktuese, me synimin për të krijuar mundësi më të mira për zhvillimin e marrëdhënieve tregtare ndërmjet dy vendeve dhe krijimin e lehtësirave të kënaqshme për transportin e mallrave dhe udhëtarëve:

duke pasur parasysh procesin europian të liberalizimit, i cili kontribuon në lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve dhe të njerëzve;

duke konsideruar çështje bazë mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë e trafikut,

kanë rënë dakord si më poshtë.

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të zbatohen në transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave dhe udhëtarëve për të tretë ose me shpërblim ose për llogari të vet ndërmjet territoreve të Palëve Kontraktuese, në transit përmes territoreve të tyre dhe për në ose nga vende të treta, të kryera nga operatorë transporti të vendosur në territorin e njërës nga Palët Kontraktuese.

2. Palët Kontraktuese do të garantojnë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshje të arritura ndërmjet Bashkimit Europian dhe Republikës së Shqipërisë dhe marrëveshje të tjera multilaterale të nënshkruara nga të dyja Palët.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje:

Termi “operatorë transporti” nënkupton një person (përfshirë një person juridik), i cili është i vendosur në territorin e një Pale Kontraktuese dhe pranohet ligjërisht në vendin e vendosjes në tregun e transportit ndërkombëtar rrugor të mallrave ose udhëtarëve për të tretë ose me shpërblim, ose për llogari të vet në përputhje me ligjet dhe rregullat e caktuara kombëtare.

2. Termi “mjet” nënkupton një mjet motorik të regjistruar në territorin e njërës nga Palët Kontraktuese ose një kombinim i mjeteve nga të cilat të paktën mjeti motorik është i regjistruar në territorin e njërës nga Palët Kontraktuese dhe që përdoret, dhe është i pajisur veçanërisht për transportin e mallrave ose transportin e udhëtarëve.

3. Termi “autobus” nënkupton një mjet për transportin e udhëtarëve i cili është i përshtatshëm nga konstruksioni dhe pajisja e tij për transportin e më shumë se nëntë personave, duke përfshirë shoferin dhe është i destinuar për këtë qëllim.

4. Termi “transport” nënkupton lëvizjen në rrugë të mjeteve të ngarkuara ose të pangarkuara, edhe në qoftë se për një pjesë të udhëtimit, mjeti, traileri ose gjysmëtraileri përdor hekurudhat ose rrugët ujore.

5. Termi “shërbim i rregullt” nënkupton një shërbim me autobus, i cili siguron transport udhëtarësh sipas një frekuence të caktuar dhe në një linjë të caktuar, gjatë së cilës udhëtarët mund të merren ose zbriten në stacione të paracaktuara. Një shërbim i rregullt mund të jetë objekt i detyrimit për të respektuar orare dhe tarifa të vendosura më parë.

Një shërbim i rregullt do të jetë i hapur për të gjithë dhe kur gjykohet e përshtatshme, do t’i nënshtrohet kushteve të detyrueshme.

6. Termi “shërbim i rregullt i posaçëm” nënkupton një shërbim autobusi, i organizuar nga kushdo, që siguron transportin e një kategorie të caktuar udhëtarësh me përjashtim të udhëtarëve të tjerë, për më tepër një shërbim i tillë kryhet sipas dispozitave të përcaktuara në pikën 5.

Shërbimet e rregullta të posaçme do të përfshijnë:

- Transportin punë-shtëpi të punonjësve;
- Transportin e nxënësve të shkollave dhe studentëve për në dhe nga institucionet edukuese.

Fakti që një shërbim i rregullt i posaçëm mund të ndryshojë në përputhje me nevojat e përdoruesve nuk do të ndikojë në klasifikimin e tij si një shërbim i rregullt.

7. Termi “shërbimi vjatje-ardhje” nënkupton një shërbim me autobus, me anë të të cilit, nëpërmjet udhëtimeve të përsëritura vajtjte-ardhje, transportohen grupe udhëtarësh të formuar më parë, nga një vend i vetëm nisjeje te një destinacion i vetëm. Çdo grup, që përbëhet nga udhëtarë të cilët bëjnë udhëtimin në vajtje, do të transportohet përsëri në vendin e nisjes në një udhëtim të mëpasëm nga i njëjti operator transporti. Vendi i nisjes dhe i destinacionit, respektivisht, do të nënkuptojnë vendin ku fillon udhëtimi dhe vendin ku mbaron udhëtimi, në secilin rast, bashkë me lokalitetin përreth, brenda një rrezeje 50 km.

Në itinerarin e një shërbimi vajtje-ardhje, asnjë udhëtar nuk mund të merret ose të zbritet gjatë udhëtimit.

Udhëtimi i parë në kthim dhe i fundit në vajtje në një seri udhëtimesh vajtje-ardhje do të bëhet bosh.

“Shërbimi vajtje-ardhje me akomodim” përfshin krahas transportit edhe akomodimin për të paktën 80% të udhëtarëve me ushqim ose pa ushqim, në vendin e destinacionit dhe kur është e nevojshme, gjatë udhëtimit. Udhëtarët do të qëndrojnë në vendin e mbërritjes për të paktën 2 netë.

Shërbimi vajtje-ardhje me akomodim mund të kryhet nga një grup operatorësh transporti që veprojnë në emër të të njëjtit kontraktor dhe udhëtarët:

- ose mund të kryejnë udhëtimin e kthimit me një transportues tjetër, prej të njëjtit grup, nga udhëtimi i vajtjes;
- ose mund të kapin një linjë “gjatë udhëtimit” me një transportues tjetër, prej të njëjtit grup.

8. Termi “shërbim i rastit” nënkupton një shërbim me autobus ndërmjet territoreve të Palëve Kontaktuese që nuk mund të jetë as brenda përkufizimit të një shërbimi të rregullt ose një shërbimi të rregullt të posaçëm, as përkufizimit të një shërbimi vajtje-ardhje. Një shërbim i tillë mund të kryhet me disa shkallë frekuence pa pushtuar së qenuri në këtë mënyrë një shërbim i rastit.

Shërbimet e rastit përfshijnë:

a) Udhëtimet me dyer të mbyllura, domethënë shërbimet, me anë të të cilave i njëjti mjet përdoret për të transportuar të njëjtin grup udhëtarësh gjatë gjithë udhëtimit dhe kthimin mbrapa në vendin e nisjes, i cili është vendi ku mjeti është i regjistruar;

b) Shërbimet, të cilat e kryejnë udhëtimin në vajtje plot dhe udhëtimin në kthim bosh;

c) Shërbimet, të cilat i kryejnë udhëtimin në vajtje bosh dhe udhëtimin në kthim plot, me udhëtarë të marrë në të njëtjën pikë të vendit ku mjeti nuk është i regjistruar, me kusht që udhëtarët:

- të përbëjnë një grup të formuar më parë sipas një kontrate të transportit të përfunduar para mbërrijes së tyre në territorin e Palës Kontraktuese ku ata janë marrë, ose

- të jenë sjellë më parë nga i njëjti tranportues sipas kushteve të rastit b, dhe me kusht që ata të jenë marrë përsëri dhe të jenë transportuar mbrapsht në territorin e vendit të vendosjes së operatorit të transportit;

- të jenë ftuar për të udhëtuar në territorin e vendit të vendosjes së operatorit të transportit ku kostoja e transportit përballohet nga personi që ka lëshuar ftesën. Udhëtarë të tillë duhet të përbëjë një grup homogjen, i cili ka qenë formuar vetëm për këtë udhëtim të veçantë.

9. Termi “transporti për llogari të vet” nënkupton:

a) Në rastin e transportit të udhëtarëve, ku transporti kryhet për qëllim jotregtare dhe jofitimprurëse nga operatorët e transportit, me kusht që:

- aktiviteti i transportit është vetëm një aktivitet ndihmës për operatorin e transportit;

- automjetet që përdoren janë në pronësi të operatorit të transportit ose të vendosura në dispozicion të tij nëpërmjet një kontrate me qira ose leasing dhe drejtohen nga anëtarë të personelit të operatorit të transportit ose nga vetë operatori i transportit;

b) Në rastin e transportit të mallrave, ku mallrat e transportuara janë pronë e operatorit të transportit ose janë shitur, blerë, të dhëna me qira ose të marra në qira, të prodhuara, të nxjerra, të përpunuara ose riparuara nga operatori i transportit. Qëllimi i transportit duhet të jetë transporti i mallrave për në ose nga ambientet e operatorit të transportit ose për t’i lëvizur ato, ose brenda ambienteve të operatorit të transportit ose jashtë për kërkesat e veta. Automjetet e përdorura për këtë transport duhet të drejtohen nga anëtarët e personelit të operatorit të transportit ose nga vetë operatori i transportit dhe të jenë pronë e operatorit të transportit ose të vëna në dispozicion të tij nëpërmjet një kontrate me qira ose leasing. Transporti duhet të jetë një aktivitet ndihmës i operatorit të transportit.

Neni 3
Hyrja në treg

Çdo Palë Kontraktuese duhet të lejojë cilindo operator transporti të vendosur në territorin e Palës tjetër Kontraktuese të kryejë transport mallrash dhe udhëtarësh:

a) ndërmjet çdo pike në territorin e tij dhe çdo pike jashtë atij territori, dhe

b) në transit përmes territorit të tij, të cilat do të jenë subjekt për leje ose autorizime, të lëshuara nga autoritetet kompetente të secilës Palë Kontraktuese.

Neni 4
Pesha dhe përmasat

1. Peshat dhe përmasat e mjeteve duhet të jenë në përputhje me regjistrimin zyrtar të mjetit dhe nuk duhet të kapërcejnë limitet në fuqi në vendin pritës.

2. Një leje e veçantë e lëshuar nga një autoritet kompetent kërkohet në qoftë se peshat dhe/ose përmasat e mjetit të ngarkuar ose të pangarkuar i angazhuar në transport sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje e kapërcejnë maksimum e lejuar në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 5
Përshtatja me legjislacionin kombëtar

Operatorët e transportit të një Pale Kontraktuese dhe ekipet e mjeteve të tyre, kur janë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, duhet të zbatojnë ligjet dhe rregullat në fuqi në atë vend.

Neni 6
Shkeljet

Në rastin e ndonjë shkeljeje të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nga një transportues i një Pale Kontraktuese, Pala Kontraktuese në territorin e të cilës kryhet shkelja, mundet, pa paragjykim për procedimin e saj ligjor, t’ia njoftojë këtë shkelje Palës tjetër Kontraktuese, e cila do të ndërmarrë hapa të

cilat janë parashikuar nga ligjet kombëtare, duke përfshirë tërheqjen e lejes ose autorizimet ose ndalimin për të kryer transporte në territorin e Palës tjetër Kontraktuese. Këto Palë Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën rreth sanksioneve që kanë vendosur.

Neni 7
Çështjet financiare

1. Mjetet, duke përfshirë pjesët e tyre të këmbimit, që janë të angazhuara në operacione transporti në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, do të përjashtohen reciprokisht nga të gjitha taksat dhe detyrimet e vendosura në qarkullimin ose pronësinë e mjeteve.

2. Nuk përjashtohen taksat dhe detyrimet mbi karburantin e motorit, tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) në operacionet e transportit, detyrimet (pagesat e segmenteve të veçanta rrugore, urave) dhe taksat e përdorimit, dhe taksat për leje të veçanta ashtu si parashikohet në nenin 4.

3. Karburanti i vendosur në depozitat normale të mjetit të ndërtuar për këtë qëllim dhe që përdoret për funksionimin e mjetit ose për funksionimin e pajisjeve për kontrollin e temperaturës, ashtu si dhe lubrifikantët e vendosur në mjete me qëllimin e vetëm, funksionimin e tyre, do të jenë reciprokisht të përjashtuar nga detyrimet doganore dhe çdo taksë dhe pagesë tjetër.

4. Pjesët e ndërrimit të kërkuara për riparimin e një mjeti tashmë të importuar do të lejohen përkohësisht nën emrin e importimit të përkohshëm pa pagesë të detyrimeve doganore dhe taksave të tjera, dhe pa pengesa dhe kufizime të importit. Pjesët e zëvendësuara duhet të çdoganohen, rieksportohen ose shkatërrohen nën kontrollin dhe vëzhgimin doganor.

Neni 8
Komiteti i përbashkët

1. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do të rregullojnë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin dhe përdorimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Për këtë qëllim Palët Kontraktuese do të ngrejnë një komitet të përbashkët.

3. Komiteti i përbashkët do të mblidhet rregullisht me kërkesë të njërës Palë Kontraktuese reciprokisht në territorin e njërës prej Palëve Kontraktuese dhe do të ketë përfaqësues të autoriteteve kompetente të administratës së Palëve Kontraktuese, të cilat mund të ftojnë përfaqësues të shoqatave të transportit rrugor.

4. Komiteti i përbashkët duhet të përcaktojë procedurat dhe rregullat e veta. Takimi duhet të përfundojë me hartimin e një protokolli që do të firmoset nga kryetarët e delegacioneve të secilës Palë kontraktuese.

5. Në vazhdim të nenit 3, komiteti i përbashkët do të vendosë për numrin dhe tipin e lejeve ose autorizimeve dhe kushtet e hyrjes në treg. Pavarësisht nga neni 12 paragrafi 2, komiteti i përbashkët mund të zgjerojë llojet e transportit për të cilat nuk kërkohen leje ose autorizime.

6. Komiteti i përbashkët do të tregojë vëmendje të veçantë për çështjet e mëposhtme:

- Zhvillimin e harmonizuar të transportit ndërmjet Palëve Kontraktuese, duke pasur parasysh ndërmjet të tjerave aspektet mjedisore të përfshira;
- Koordinimin e politikave të transportit, legjislacionit të transportit dhe zbatimin e tij nga Palët Kontraktuese në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Formulimin e zgjidhejve të mundshme për autoritetet respektive kombëtare nëse ka probleme, veçanërisht në fushën e çështjeve fiskale, sociale, doganore dhe mjedisore, duke përfshirë çështjet e rendit publik që ndikojnë në operimet e transportit;
- Shkëmbimin e informacionit përkatës;
- Metodën e përcaktimit të përmasave dhe peshave;
- Nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve dhe institucioneve të transportit;
- Nxitjen e transportit të kombinuar, që përfshin të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me hyrjen në treg.

PJESA II
DISPOZITA PËR TRANSPORTIN E UDHËTARËVE

Neni 9
Shërbimet e rregullta

1. Aplikimet për autorizime për shërbimet e rregullta do të dorëzohen pranë autoriteteve

kompetente në vendin e territorin e të cilit është vendosur pika e nisjes.

2. Vendimi për të lëshuar autorizime do të ndërmerret bashkërisht nga autoritetet e Palëve Kontraktuese. Ato lëshohen nga autoritetet kompetente të të dyja Palëve Kontraktuese, secila për territorin e saj.

3. Një aplikim për një autorizim mund të refuzohet nëse, ndër të tjerash:

- aplikuesi e ka të pamundur të sigurojë shërbimin e cili është subjekt i aplikimit me pajisjet që ai ka direkt në dispozicion të tij;

- në qoftë se në të kaluarën aplikuesi nuk ka zbatuar legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar mbi transportin rrugor dhe në veçanti kushtet dhe kërkesat që lidhen me autorizimet për shërbimet e transportit ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve ose ka kryer thyerje serioze të legjislacionit në lidhje me sigurinë rrugore, në veçanti përsa i takon rregullave të zbatueshme për mjetet dhe drejtimin dhe periudhën e pushimit të shoferave;

- në qoftë se, në rastin e një aplikimi për rinovimin e autorizimit, kushtet e autorizimit nuk janë zbatuar.

4. Një vendim nëse një autorizim do të lëshohet, do të ndërmerret nga autoritetet kompetente brenda tre muajve nga data në të cilën është marrë një aplikim i plotë.

5. Një autorizim do të jetë i vlefshëm për një periudhë maksimale prej tre vitesh dhe mund të zgjatet me kërkesë.

6. Autorizimi ose një kopje e tij e legalizuar do të mbahet në mjet.

Neni 10
Shërbimet vajtje-ardhje

1. Nuk do të kërkohet autorizim për shërbimet vajtje-ardhje me akomodim të kryer nga operatorët e transportit shqiptar ose operatorët e transportit belg nëse këto shërbime e kanë nisjen e tyre respektivisht në Shqipëri dhe Belgjikë.

2. Shërbimet vajtje-ardhje pa akomodim trajtohen si shërbime të rregullta.

3. Për shërbimet vajtje-ardhje të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, do të përdoret doumenti i udhëtimit të udhëtarëve i plotësuar tërësisht.

Neni 11
Shërbimet e rastit

Nuk do të kërkohet autorizim për shërbimet e rastit që klasifikohen sipas nenin 2.8 a), b) dhe c) nëse plotësohen kushtet. Shërbimet që klasifikohen sipas nenit 2.8 d) janë subjekt autorizimi.

Një dokument udhëtimi i udhëtarëve, i plotësuar tërësisht, do të mbahet në mjet.

PJESA III
DISPOZITAT PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE

Neni 12
Kushtet e lejes

1. Lejet për transportin e mallrave do të lëshohen brenda kufijve të një kuote për 1(një) udhëtim (vajtje-ardhje) ose secila për 1(një) vit dhe do të jetë e vlefshme për një periudhë 13-mujore, duke filluar që nga 1 janari i çdo viti kalendarik. Lejet do të mbahen në mjet.

2. Lejet janë personale dhe nuk janë të transferueshme te palë të treta.

3. Lejet mund të përdoren vetëm njëherë për një makinë.

4. Komiteti i përbashkët referuar në nenin 8 përcakton kuotën, kategoritë e lejeve (udhëtimin dhe kohën) dhe çdo kusht tjetër që kontrollon përdorimin e lejes.

5. Nuk do të kërkohet leje ose autorizim për llojet e mëposhtme të transportit ose për udhëtimet bosh të kryera në lidhje me transporte të tilla si:

a) Transporti i mallrave me automjete, pesha totale e lejuar e ngarkesës (TPLW) e të cilave, duke përfshirë trailerat, nuk i kalon 6 tonët, ose kur ngarkesa e lejuar e mallit, duke përfshirë trailerat, nuk i kalon 3.5 tonët;

b) Transporti i mallrave, mbi një bazë të rastësishme, për në ose nga aeroportet, në rastet kur

shërbimet janë devijuar;

c) transporti i mjeteve të cilat janë dëmtuar ose kanë difekte dhe transporti i mjeteve për riparimin e difekteve;

d) Udhëtimet pa ngarkesë të një mjeti mallrash i dërguar për të zëvendësuar një mjet i cili ka pësuar difekt në një vend tjetër, si dhe udhëtimi i kthimit, pas riparimit të mjetit që kishte difekt;

e) Transporti i gjësë së gjallë në mjete të ndërtuara për këtë qëllim ose përkohësisht të konvertuara për transportin e gjësë së gjallë dhe të njohura si të tilla nga autoritetet e interesuara të Palëve Kontraktuese;

f) Transporti i pjesëve të këmbimit dhe i rezervave për anijet transoqeanike dhe për avionët;

g) Transporti i furnizimeve dhe pajisjeve mjekësore të nevojshme për urgjenca, në veçanti në rastet e katastrofave natyrore dhe nevojave humanitare;

h) Transporti i punimeve dhe objekteve të artit për panaire dhe ekspozita për qëllime jotregtare;

i) Transporti për qëllime jotregtare i rekuizitave, aksesorëve dhe kafshëve për në ose nga shfaqje teatrale, muzikore, filma, sporti ose cirku, panaire ose festivale, dhe ato për qëllim regjistrimi radiofonik, ose për filma ose prodhime televizive;

j) Transporti i mallrave për llogaritë vet;

k) Transporti funeral;

l) Transporti i postës, i kryer si një shërbim publik;

6. Leja duhet të plotësohet para fillimit të udhëtimit. Dokumenti duhet të vuloset nga doganat në kohën e hyrjes në territorin e Palës tjetër Kontraktuese. Kur kufiri kalohet në një vend ku nuk ka dogana, shoferi duhet të shkruajë me bojë në leje, në vendin e vulës së doganës, vendin, datën dhe orën e kalimit të kufirit.

7. Në përputhje me nenin 4 paragrafi 2, kërkesa për një autorizim të veçantë për mjetet që transportojnë mallra, pesha dhe përmasat e të cilave i kalojnë kufijtë e lejuar në territorin e Palës Kontraktuese pritëse, duhet të përmbajë:

1. Emrin dhe adresën e operatorit;
2. Prodhuesin e mjetit, tipin dhe targat;
3. Numrin e akseve dhe shpërndarjen e akseve;
4. Përmasat dhe peshën e mjeteve;
5. Kapacitetin e ngarkimit;
6. Përmasat dhe peshën e mallrave;
7. Në qoftë se është e nevojshme, përshkrimin e mjetit së bashku me mallrat;
8. Ngarkesën për çdo aks;
9. Adresa e vendit të ngarkimit dhe shkarkimit;
10. Vendin e planifikuar të kalimit kufitar, datën, si dhe itinerarin.

PJESA IV
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 13
Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë pas datës në të cilën Palët Kontraktuese kanë informuar njëra-tjetrën me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike që janë plotësuar kërkesat ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes në vendet e tyre respektive.

2. Palët Kontraktuese mund ta përfundojnë këtë Marrëveshje në çdo kohë duke njoftuar me shkrim gjashtë muaj më parë Palën tjetër Kontraktuese.

Në dëshmi të sa më sipër, nënshkruesit, të autorizuar posaçërisht, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në dy kopje origjinale në gjuhën angleze në……